

VENDIM
Nr. 101, datë 7.11.2014

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “UKKO” SHA, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA IMPIANTE FOTOVOLTAIKE ME FUQI 1 MW**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të “rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, VKM-së nr. 196, datë 2.4.2014 “Për miratimin e autorizimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik fotovoltaik të shoqërisë “UKKO” sh.a., Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “UKKO” sh.a., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impiante fotovoltaike me fuqi 1 MW, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për këtë aplikim,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “UKKO” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik : neni 9, pika 4.4.2 (Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin); l neni 9, pika 4.4.3 (Dokumentacioni teknik dhe grafik); neni 9, pika 4.4.4 (Dokumentacioni tekniko- ekonomik); neni 9, pika 4.4.5 (Leje nga institucione te tjera)) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “UKKO” sh.a., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impiante fotovoltaike me fuqi 1 MW për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti